



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:066425

Datë: 12.10.2024

Numri i dokumentit: 06289368

C.nr.568/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.B., A.G., M.K., S.S., F.B, A.L. të cilët me autorizim i përfaqëson av. A.S. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 11.12.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses M.K. **si e bazuar.**

II.APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.B., A.G., M.K., S.S., F.B, A.L.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve:

- A.B. në emër të kompensimit të pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 31.08.2018, për 4 muaj e 18 ditë pune, për periudhën kohore prej datës 01.09.2018 deri më datën 31.08.2019, për 12 muaj, për periudhën kohore prej datës 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020 për 12 muaj dhe për periudhën kohore prej datës 01.09.2020 deri me datën 01.02.2021 për 6 muaj, gjithsej për 34 muaj e 18 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 2,793.75 euro.
- A.G. në emër të kompensimit të pagës për 20 % mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 30.06.2018, gjithsej për 2 muaj e 17 ditë, t'ia paguaj shumën 179.34 euro.

- M.K. në emër të kompensimit të pagës për 20 % mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri më datën 31.12.2019 dhe prej datës 01.01.2020 deri më datën 31.12.2020, gjithsej për 24 muaj, t'ia paguajë shumën prej 2,020.80 euro.
- S.S. në emër të kompensimit të pagës për 20 % mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 31.08.2019, për 8 muaj e 17 ditë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019, për 12 muaj dhe për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 deri më datën 31.12.2020, për 12 muaj, gjithsej për 32 muaj e 17 ditë, t'ia paguaj shumën prej 2,708.71 euro.
- F.B. në emër të kompensimit të pagës për 20 % mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 31.08.2018, për 4 muaj e 18 ditë pune, për periudhën kohore prej datës 01.09.2018 deri më datën 31.08.2019, për 12 muaj, për periudhën kohore prej datës 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020 për 12 muaj dhe për periudhën kohore prej datës 01.09.2020 deri me datën 01.02.2021 për 5 muaj, gjithsej për 33 muaj e 18 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 2,793.75 euro.
- A.L. në emër të kompensimit të pagës për 20 % mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 31.12.2018, për 8 muaj, e 17 ditë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019 për 12 muaj dhe për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020 për 12 muaj, gjithsej për 32 muaj e 17 t'ia paguaj shumën prej 2,708.71 euro, të cilat shuma është e detyruar e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit që t'ia paguaj paditësve të lartcekur dhe shumat e lartcekura për secilin veç e veç, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të kërkesës te e paditura me datë 15.03.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë për paditësit A.B. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 1,092.08 euro, për paditësen A.G. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 915.26 euro, për paditësin S.S. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 1,005.35 euro, për paditësen F.B. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 1,092.08 euro dhe për paditësen A.L. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 1,005.35 euro, **refuzohet si e pa bazuar.**

V. DETYROHET e paditura, që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **352.00 (treqind e pesëdhjetë e dy) euro**, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsy et im

Paditësit A.B., A.G., M.K., S.S., F.B, A.L. përmes të autorizuarit të tyre av. A.S. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datën 12 prill 2021, kanë parashtruar padi për kompensimi e pagës për 20 % mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit.

Në padi, i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit A.B., A.G., M.K., S.S., F.B, A.L. janë arsimtar të cilët punojnë me klasë të kombinuar pranë shkollave SHFMU (Grncare, Motrat Qiriazhi, Ibrahim Fehmiu dhe Mushnikovë) në Komunën e Prizrenit. Më tutje sipas të autorizuarit të paditësve bazë në aspektin e legjislacionit në fuqi janë: Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë, Ligji i Punës, si dhe Ligji i Procedurës Kontestimore. Po ashtu, sipas të autorizuarit të paditësve paditësi A.B. punon në shkollën “Motrat Qiriazhi”, A.G. punon në shkollën SHFMU “Grncare”, Medina Kodra punon në shkollën “Mushnikovë”, S.S. punon në shkollën “Mushnikovë”, F.B. punon në shkollën “Motrat Qiriazhi” dhe A.L. punon në shkollën “Mushnikovë”, ku të gjithë i plotësojnë kushtet e nevojshme për Kompensimin e pagës për 20 % mbi pagë e rregullt, e cila parashihet në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë. Gjithashtu, sipas të autorizuarit të paditësve pasi që për secilin paditës deri më tani nuk janë paguar shtesat për punën me klasë të kombinuara me 20%, paditësit me kërkesë i janë drejtuar Drejtorisë Komunale për Arsimi, për kompensimin e këtyre shtresave mirëpo DKA-ja, është përgjigjur negativisht, andaj mbi këtë bazë është drejtuar gjykatës. Ndërsa, me parashtrësën e datës 25.03.2022 ka bërë rregullimin e padisë, në aspektin objektiv dhe subjektiv sa i përket shumave të kompensimit, ku ka shtuar se, e paditura detyrohet paditësit me pagesën e diferencës, në emër të punës me klasë të kombinuar, në vlerë prej 84.20 euro për çdo muaj (20 % e pagës bazë 421 euro, veç e veç dhe atë për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri në datën 17.04.2021 dhe atë: për paditësin A.B. për kompensimin e pagave shtesë, në emër të punës me klasë të kombinuar për 46 muaj e 15 ditë, t'i paguaj shumën prej 3,885.83 euro – $46.15 \times 84.20 = 3,885.83$ euro, për paditësen A.G. për kompensimin e pagave shtesë, në emër të punës me klasë të kombinuar për 13, t'i paguaj shumën prej 1,094.60 euro – $13 \times 84.20 = 1,094.60$ euro, për paditësen M.K. për kompensimin e pagave shtesë, në emër të punës me klasë të kombinuar për 24 muaj, t'i paguaj shumën prej 2,020.80 euro – $24 \times 84.20 = 2,020.80$ euro, për paditësin S.S. për kompensimin e pagave shtesë, në emër të punës me klasë të kombinuar për 44 muaj e 11 ditë, t'i paguaj shumën prej 3,714.06 euro –

$44.11 \times 84.20 = 3,714.06$ euro, për paditësen F.B. për kompensimin e pagave shtesë, në emër të punës me klasë të kombinuar për 46 muaj e 15 ditë, t'i paguaj shumën prej 3,885.83 euro - $46.15 \times 84.20 = 3,885.83$ dhe për paditësen A.L. për kompensimin e pagave shtesë, në emër të punës me klasë të kombinuar për 44 muaj e 11 ditë, t'i paguaj shumën prej 3,714.62 euro - $44.11 \times 84.20 = 3,714.62$ euro. Në fund gjykatës i ka propozuar, që e njëjta të merr aktgjykim dhe padinë e kërkesëpadinë e paditëseve ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë 624 euro për padi dhe 60 për taksën gjyqësore.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve. Ka theksuar se paditësit pretendojnë se iu takon kompensimi i pagës për 20 % mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuar nuk janë të bazuara, sepse secili prej mësimdhënësve posedon kontratën e punës, në të cilën është e precizuar se gjatë javës janë 40 orë punë dhe paga është fikse ashtu siç janë dakorduar edhe në kontratë dhe se nuk është asnjë anekse që e parasheh një pagesë të tillë. Po ashtu, nuk kanë ushtruar dhe nuk kanë kaluar procedurat administrative sepse nuk i kanë vazhduar procedurat në Inspektoratin e punës në Prizren dhe nuk i kanë shtjeru të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, por janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr.05/031. Po ashtu e drejta për kompensim me klasë të kombinuar për vitin 2017 dhe deri më 12.04.2018 është e parashkruar, sepse neni 87 i Ligjit të Punës nr.03 L/L-212, decidivisht e përcakton se kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda 3 vitesh, ndërsa në këtë rast padia është parashtruar më 12.04.2021. Gjithashtu sipas tyre Qeveria e Kosovës është garantuese për implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe se Ministria e Arsimit është dashur të fillon realizimin e të drejtave që dalin nga KKAK, duke planifikuar buxhet në bashkërendim me Ministrinë e Financave, po e cila nuk e ka caktuar kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Kontrata Kolektive, ashtu që Komuna e Prizrenit rrezikon planifikimin buxhetor dhe në këtë mënyrë nuk mund të vepron në kundërshtim me ligjin për Buxhet, sa i përket tejkalimeve buxhetore të planifikuara. Andaj, Komuna e Prizrenit rrezikon planifikimin buxhetor dhe në këtë mënyrë nuk mund të vepron në kundërshtim me ligjin për buxhetin nr.07/L-041, sa i përket tejkalimeve buxhetore të planifikuara për vitin 2022. Gjithashtu sipas tyre marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Ashtu që, bazuar në këto fakte, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses M.K. është në tërësi e bazuar,

ndërsa e paditësve A.B., A.G., M.K., S.S., F.B, A.L. janë pjesërisht të bazuara, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitivin nën I dhe II të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek të paditurit, në SH.F.M.U. "Motrat Qiriazi", SH.F.M.U."Grncare", SH.F.M.U. "Mushnikova" Komuna e Prizrenit, e cila bie në kompetencë të paditurës.

Gjykata përmes vërtetimeve të lëshuar nga ana e të paditurës, vërtetimit me numër të referencës 33/21, e datës 03.03.2021 të lëshuar për paditësin A.B. vërtetimit me numër të protokollit 261/2021, e datës 24.02.2021 të lëshuar për paditësen A.G. vërtetimit me numër të referencës 47/21 e datës 02.03.2021 të lëshuar për paditësen M.K. vërtetimit me numër të referencës 46/21 e datës 01.03.2021 të lëshuar për paditësin S.S. vërtetimit me numër të referencës 34/21 e datës 01.03.2021 të lëshuar për paditësen F.B. vërtetimit me numër të referencës 45/21 e datës 01.03.2021 të lëshuar për paditësen A.L. ka vërtetuar faktin se paditësit A.B. nga data 17.04.2017 deri më datën 31.08.2017, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (II-7) dhe klasën (V-7) gjithsej katër muaj e gjysëm (4.5 muaj), nga data 01.09.2017 deri më datën 31.08.2018, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (III-7) dhe klasën (I-7) gjithsej dymbëdhjetë muaj (12 muaj), nga data 01.09.2018 deri më datën 31.08.2019, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (IV-7) dhe klasën (II-7) gjithsej dymbëdhjetë muaj (12 muaj), nga data 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (V-7) dhe klasën (III-7) gjithsej dymbëdhjetë muaj (12 muaj) dhe nga data 01.09.2020 deri me datën 01.02.2021, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (I-7) dhe klasën (IV-7) gjithsej gjashtë muaj (6 muaj), paditësja A.G. nga data 18.04.2017 deri më datën 30.06.2017, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (I-1) dhe klasën (IV-1) gjithsej tre muaj (3 muaj), dhe nga data 01.09.2017 deri më datën 30.06.2018, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (II-1) dhe klasën (V-1) gjithsej dhjetë muaj (10 muaj), paditësja M.K. nga data 01.09.2019 deri më datën 31.12.2019 dhe nga data 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara, paditësi S.S. nga data 19.04.2017 deri më datën 31.12.2020, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara, paditësja F.B. nga data 17.04.2017 deri më datën 31.08.2017, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (II-7) dhe klasën (V-7) gjithsej katër muaj e gjysëm (4.5 muaj), nga data 01.09.2017 deri më datën 31.08.2018, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (III-7) dhe klasën (I-7) gjithsej dymbëdhjetë muaj (12 muaj), nga data 01.09.2018 deri më datën 31.08.2019, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (IV-7) dhe klasën (II-7) gjithsej dymbëdhjetë muaj (12 muaj), nga data 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara klasën (V-7) dhe klasën (III-7) gjithsej dymbëdhjetë muaj (12 muaj) dhe nga data 01.09.2020 deri me datën 01.02.2021, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të

kombinuara klasën (I-7) dhe klasën (IV-7) gjithsej gjashtë muaj (6 muaj) dhe paditësja A.L. nga data 19.04.2017 deri më datën 31.12.2020, ka mbajtur (punuar) mësim me klasë të kombinuara.

Nga kërkesa e datës 15.03.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i janë drejtuar Komunës së Prizrenit-Drejtorisë Komonale të Arsimit, për pagesën shtesë mbi pagën e rregullt të mësimit me klasë të kombinuara.

Nga kontratat e punës për mësimdhënës gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit si mësimdhënës kanë krijuar marrëdhënie pune më të paditurën në SH.F.M.U. "Motrat Qiriazit", SH.F.M.U. "Grncare", SH.F.M.U. "Mushnikova" në Komunën e Prizrenit.

Vërtetimet dhe kontratat e lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të Nenit 329 par.1, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj, kontratat e punës për mësimdhënës dhe vërtetimet e lëshuara nga SH.F.M.U. "Motrat Qiriazit", SH.F.M.U. "Grncare", SH.F.M.U. "Mushnikova" Komuna e Prizrenit, si prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur me prezencën e tyre në punë dhe për përvojën në punë, Gjykata ia fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe e datës 22.01.2021.

Me nenin 45 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, është përcaktuar *"Nga Kontrata Kolektive, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t'i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive, lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmuajorin e parë përdoren rregullat dhe dispozitat e kontratës së vjetër"*.

Me nenin 11 par.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe nenin 11 par.4 Të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, thuhet se *"Mësimdhënësit që punojnë me klasë të kombinuar duhet të kompensohen për 20 % mbi pagën e rregullt"*.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *"Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë*

pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si mësimdhënës t’ia paguaj kompensimin në emër të punës me klasë të kombinuara, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës dhe atë për paditësen M.K. në emër të kompensimit të pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuar, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri më datën 31.12.2019 dhe prej datës 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020, gjithsej për 24 muaj t’ia paguaj shumën prej 2,020.80 euro. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditëses Medina Kodra sikurse në pikën nën I dhe III, pika (c) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket dispozitivit nën II dhe III pika (a), (b) (d), (e), (f) të këtij aktgjykimi, gjykata e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë dhe atë për paditësin: A.B. në emër të kompensimit të pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuar, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 31.08.2018, për 4 muaj e 18 ditë pune, për periudhën kohore prej datës 01.09.2018 deri më datën 31.08.2019, për 12 muaj, për periudhën kohore prej datës 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020 për 12 muaj dhe për periudhën kohore prej datës 01.09.2020 deri me datën 01.02.2021 për 6 muaj, gjithsej për 34 muaj e 18 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 2,793.75 euro, për paditësen A.G. në emër të kompensimit të pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuar, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 30.06.2018, gjithsej për 2 muaj e 17 ditë, t’ia paguaj shumën 179.34 euro, për paditësin S.S. në emër të kompensimit të pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuar, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 31.08.2019, për 8 muaj e 17 ditë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019, për 12 muaj dhe për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 deri më datën 31.12.2020, për 12 muaj, gjithsej për 32 muaj e 17 ditë, t’ia paguaj shumën prej 2,708.71 euro, për paditësen F.B. në emër të kompensimit të pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuar, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 31.08.2018, për 4 muaj e 18 ditë pune, për periudhën kohore prej datës 01.09.2018 deri më datën 31.08.2019, për 12 muaj, për periudhën kohore prej datës 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020 për 12 muaj dhe për periudhën kohore prej datës 01.09.2020 deri me

datën 01.02.2021 për 5 muaj, gjithsej për 33 muaj e 18 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 2,793.75 euro dhe për paditësen A.L. në emër të kompensimit të pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimimit me klasë të kombinuar, gjatë punës për periudhën kohore prej datës 13.04.2018 deri më datën 31.12.2018, për 8 muaj, e 17 ditë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019 për 12 muaj dhe për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020 për 12 muaj, gjithsej për 32 muaj e 17 t'ia paguaj shumën prej 2,708.71 euro. Andaj, mbi këtë bazë gjykata e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve.

Ndërsa sa i përket dispozitivit nën IV të këtij aktgjykimi, gjykata, e refuzoj kërkesëpadinë e paditësit A.B. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 1,092.08 euro, paditëses A.G. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 915.26 euro, paditësit S.S. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 1,005.35 euro, paditëses F.B. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 1,092.08 euro dhe paditëses A.L. mbi shumën e aprovuar e deri në lartësi prej 1,005.35 euro.

Gjykata ka vendosur si në pikën nën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palëve paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“ të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësit A.B., A.G., M.K., S.S., F.B, A.L. padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 12.04.2021, ndërsa kërkesa e paditësit A.B. ka qenë për kompensimin e pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimimit me klasë të kombinuar, për periudhën kohore prej datës 17.04.2017 deri më datën 31.08.2017, nga data 01.09.2017 deri më datën 31.08.2018, nga data 01.09.2018 deri me datën 31.08.2019, nga data 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020 dhe nga data 01.09.2020 deri më datën 01.02.2021. Rrjedhimisht, paditësit A.B. i është parashkruar pjesa e kërkesës për periudhën prej datës 17.04.2017 deri më datën 31.08.2017 dhe për periudhën prej datës 01.09.2017 deri me datën 12.04.2018, ndërsa paditësi ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tij në procedurë gjyqësore për periudhën prej datës 13.04.2018 deri më datën 31.08.2018, prej datës 01.09.2018 deri me datën 31.08.2019, prej datës 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020 dhe prej datës 01.09.2020 deri më datën 01.02.2021. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit A.B. sikurse në pikën nën II dhe III pika (a) të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV të dispozitivit të aktgjykimit. Për paditësen A.G. kërkesa ka qenë për kompensimin e pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimimit me klasë të kombinuar, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri me datën 30.06.2017 dhe për periudhën prej datës 01.09.2017 deri me datën 30.06.2018. Rrjedhimisht, paditëses A.G. i është parashkruar pjesa e kërkesës për periudhën prej datës 18.04.2017 deri me datën 30.06.2017 dhe për periudhën prej datës 01.09.2017 deri me datën 12.04.2018, ndërsa paditësja ka ndërprerë rrjedhjen e

parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore për periudhën prej datës 13.04.2018 deri me datën 30.06.2018. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses A.G. sikurse në pikën nën II dhe III pika (b) të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV të dispozitivit të aktgjykimit. Për paditësin S.S.i kërkesa ka qenë për kompensimin e pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, për periudhën kohore prej datës 19.04.2017 deri me datën 31.12.2017, prej datës 01.01.2018 deri me datën 31.12.2018, prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019 dhe prej datës 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020. Rrjedhimisht, paditësit S.S. i është parashkruar pjesa e kërkesës për periudhën prej datës 19.04.2017 deri me datën 31.12.2017 dhe për periudhën prej datës 01.01.2018 deri me datën 12.04.2018, ndërsa paditësi ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tij në procedurë gjyqësore për periudhën prej datës 13.04.2018 deri me datën 31.12.2018, prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019 dhe prej datës 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit S.S. sikurse në pikën nën II dhe III pika (d) të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV të dispozitivit të aktgjykimit. Për paditësen F.B. kërkesa ka qenë për kompensimin e pagës për 20% mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, për periudhën kohore prej datës 17.04.2017 deri me datën 31.08.2017, prej datës 01.09.2017 deri me datën 31.08.2018, prej datës 01.09.2018 deri me datën 31.08.2019, prej datës 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020 dhe prej datës 01.09.2020 deri me datën 01.02.2021. Rrjedhimisht, paditëses Fatima Bilibani i është parashkruar pjesa e kërkesës për periudhën prej datës 17.04.2017 deri me datën 31.08.2017 dhe për periudhën prej datës 01.09.2017 deri me datën 12.04.2018, ndërsa paditësja ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore për periudhën prej datës 13.04.2018 deri me datën 31.08.2018, prej datës 01.09.2018 deri me datën 31.08.2019, prej datës 01.09.2019 deri me datën 31.08.2020 dhe prej datës 01.09.2020 deri me datën 01.02.2021. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses Fatima Bilibani sikurse në pikën nën II dhe III pika (e) të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV të dispozitivit të aktgjykimit dhe për paditësen A.L. kërkesa ka qenë për kompensimin e pagës për 20 % mbi pagën e rregullt gjatë mësimit me klasë të kombinuara, për periudhën kohore prej datës 19.04.2017 deri me datën 31.12.2017, prej datës 01.01.2018 deri me datën 31.12.2018, prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019 dhe prej datës 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020. Rrjedhimisht, paditëses A.L. i është parashkruar pjesa e kërkesës për periudhën prej datës 19.04.2017 deri me datën 31.12.2017 dhe për periudhën prej datës 01.01.2018 deri me datën 12.04.2018, ndërsa paditësja ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore për periudhën prej datës 13.04.2018 deri me datën 31.12.2018, prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019 dhe prej datës

01.01.2020 deri më datën 31.12.2020. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses A.L. sikurse në pikën nën II dhe III pika (f) të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 312.00 euro për përpilimin e padisë, për taksën gjyqësore shumë prej 40.00 euro, (pasi që kjo është shuma të cilën e ka paguar i autorizuari i paditësve për taksë) apo gjithsej shumë prej 352.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, pasi që kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e provuara dhe të specifikuara.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.568/2021, me datë 11.10.2024

Gj y q t a r i

Gëzim Shehu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.